



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 10

Tiranë – E mërkurë, 31 janar 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 3/2018, datë 25.1.2018	Për rrëzimin e listës në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”..... 367
Vendim i Kuvendit nr. 4/2018, datë 25.1.2018	Për rrëzimin e listës në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”..... 367
Vendim i Kuvendit nr. 5/2018, datë 25.1.2018	Për emërimin e zotit Ildir Gjata anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare..... 368
Vendim i Kuvendit nr. 6/2018, datë 25.1.2018	Për zgjedhjen e zotit Helidon Bushati anëtar i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës..... 368
Vendim i Kuvendit nr. 7/2018, datë 25.1.2018	Për zgjedhjen e zonjës Adriana Berberi anëtare e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës..... 368
Vendim i Kuvendit nr. 8/2018, datë 25.1.2018	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar... 368
Dekret i Presidentit nr. 10714, datë 26.1.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 369
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 19, datë 19.1.2018	Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike, për vitin 2018 369
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 20, datë 19.1.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror, nga shoqëria Albgaz sh.a., për vitin 2018..... 370
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 827, datë 17.1.2018	Mbi hyrjen në fuqi të MoU me Azerbajxhanin..... 371

**VENDIM**
Nr. 3/2018**PËR RRËZIMIN E LISTËS NË BLOK**
TË KANDIDATËVE TË PËRZGJEDHUR
PËR ANËTARË TË KËSHILLIT
TË LARTË GJYQËSOR, SIPAS LIGJIT
NR. 115/2016, “PËR ORGANET
E QEVERISJES SË SISTEMIT
TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të pikës 8, të nenit 147 të Kushtetutës dhe të pikës 16, të nenit 35, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës në bllok të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në nënkomisionin “Për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, si më poshtë:

1. Arben Vani (nga avokatia)
2. Sokol Lamaj (nga avokatia)
3. Erjon Muharremaj (nga trupa e pedagogëve)
4. Ilir Panda (nga trupa e pedagogëve)
5. Altin Hazizaj (nga shoqëria civile)

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 25.1.2018

VENDIM
Nr. 4/2018**PËR RRËZIMIN E LISTËS NË BLOK**
TË KANDIDATËVE TË PËRZGJEDHUR
PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË
LARTË TË PROKURORISË, SIPAS LIGJIT
NR. 115/2016, “PËR ORGANET
E QEVERISJES SË SISTEMIT
TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të pikës 8, të nenit 149 të Kushtetutës dhe të pikës 16, të nenit 35, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës në bllok të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në nënkomisionin “Për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, si më poshtë:

1. Floreta Gjini (nga avokatia)
2. Kozma Jano (nga avokatia)
3. Eneida Sema (nga trupa e pedagogëve)
4. Mirela Bogdani (nga trupa e pedagogëve)
5. Alfred Balla (nga shoqëria civile)

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 25.1.2018

**VENDIM
Nr. 5/2018****PËR EMËRIMIN E ZOTIT IDLIR GJATA
ANËTAR I BORDIT TË AUTORITETIT
TË MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 111, pika 3, të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 6, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Idhir Gjata emërohet anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas propozimit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 25.1.2018

**VENDIM
Nr. 6/2018****PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT HELIDON
BUSHATI ANËTAR I KOMISIONIT TË
AUTORITETIT TË KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 20, 21 dhe 22, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e 28 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Helidon Bushati zgjidhet anëtar i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 25.1.2018

**VENDIM
Nr. 7/2018****PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS ADRIANA
BERBERI ANËTARE E KOMISIONIT TË
AUTORITETIT TË KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 20, 21 dhe 22, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e 28 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Adriana Berberi zgjidhet anëtare e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 25.1.2018

**VENDIM
Nr. 8/2018****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 90/2017, “PËR ÇAKTIMIN
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 55, pika 1, dhe 21, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, “Për çaktimin e anëtarësisë së komisioneve të përherëshme të Kuvendit”, bëhet kjo shtesë:

I. Deputetja Elena Xhina caktohet anëtare në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 25.1.2018

**DEKRET****Nr. 10714, datë 26.1.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Bashkim Beqir Kastrati
2. Lea Berat Buzhalla
3. Sarah Berat Buzhalla
4. Ashraf Hassan Ismail Hashem

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**
Ilir Meta

VENDIM**Nr. 19, datë 19.1.2018****MBI ÇMIMIN VJETOR TË BLERJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T’U
PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES
ME PËRPARËSI TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 10, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017, “Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”; si dhe nenit 19, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve

në lidhje me miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, për vitin 2018,

konstatoi se:

- Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, për llogaritjen e këtij çmimi parashikon:

- Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kwh) = çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profiling bandë (*baseload*) të vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike, në euro cent/kwh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.3 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë, për vitin e fundit.

- Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) rezulton se çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike, në profiling bandë (*baseload*) për vitin 2017, është në vlerën 50.35 euro/mwh.

- Nga të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit lekë/euro, për çdo muaj të vitit 2017, kursi mesatar i këmbimit për vitin 2017 rezulton 134.15 lekë/euro. Në rast se kursi i këmbimit lekë/euro, që do të publikohet në “Raportin vjetor 2017” të Bankës së Shqipërisë, ndryshon nga çmimi mesatar i llogaritur, ERE rezervon të drejtën që të rishikojë llogaritjet në zbatim të metodologjisë.

- Në zbatim të formulës për llogaritëse të pikës 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017, “Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, rezulton si më poshtë:

$$P_u = 50.35 / 1000 * 1.3 * 134.15 = 8.78078825 \text{ lekë/kwh}$$

- Paragrafët 2/ç dhe 2/d, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017, “Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, parashikojnë që çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, mund të jetë jo më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 dhe jo më i lartë se 15% e çmimit të miratuar nga ERE për vitin 2016.



- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 13 datë 16.2.2016, ka vendosur që tarifa fikse e energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet, për vitin 2016, do të jetë 7.448 lekë/kwh.

- Parashikimet e paragrafëve 2/ç dhe 2/d, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017, "Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi", referuar çmimit të miratuar me vendimin nr. 13 datë 16.2.2016, të bordit të ERE-s, prodhojnë një rezultante në vlerën 8.5652 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, për vitin 2018, do të jetë 8.5652 lekë/kwh.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 20, datë 19.1.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR, NGA SHOQËRIA ALBGAS SHA, PËR VITIN 2018

Në mbështetje të neneve 13, pika 2; 17, pika 1, germa "e", dhe 33, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror"; të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; si dhe nenit 19 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve në lidhje me miratimin e tarifës së shoqërisë Albga

sh.a., si operator i transmetimit të gazit natyror, për vitin 2018,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 85/1 prot., datë 3.1.2018 (protokolluar në ERE me nr. 13 prot., datë 4.1.2018), Albga sh.a., ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, ka certifikuar shoqërinë operatori i kombinuar i gazit natyror, Albga sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 10.11.2017, ka licencuar shoqërinë Albga sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

- Me vendimin, nr. 90, datë 7.6.2017, bordi i ERE-s ka miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albga sh.a., për periudhën 5.1.2017–20.9.2017.

- Me vendimin nr. 155, datë 28.9.2017, të bordit të ERE-s është vendosur mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 90, datë 7.6.2017, "Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albga sh.a., për periudhën 5.1.2017–20.9.2017", deri më 31.12.2017.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, ka miratuar "Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror".

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 14, datë 10.1.2018, është vendosur për shtyrjen e afatit të tarifës së përkohshme të transmetimit për shoqërinë Albga sh.a., miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 90, datë 7.6.2017, deri në datën 31.3.2018.

- Nuk është respektuar afati i aplikimit në zbatim të nenit 21, pika 3 të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror", miratuar me vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, të bordit të ERE-s.

- Aplikimi duhet të shoqërohet me analiza dhe argumente për të gjitha shpenzimet operative të vitit ushtrimor të mbyllur, duke dërguar në ERE pasqyrat financiare paraprake për vitin 2017.

- Mungojnë argumentet dhe analiza e detajuara mbi nivelin e propozuar për të gjitha elementet përbërëse të kostove operative, konform nenit 7 dhe nenit 8 të "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të



shpërndarjes së gazit natyror, për periudhën e ardhshme 2018.

- Aplikimi duhet të plotësohet me analizat e llogaritjeve të bazës së rregulluar të aseteve (RAB), për vitin 2017, për të evidentuar dhe për të paraqitur në këtë mënyrë gjendjen dhe lëvizjet e aseteve të krahasuara me pasqyrat financiare përkatëse.

- Shoqëria ende nuk ka paraqitur planin e investimeve për vitin 2018, me qëllim llogaritjen e RAB-së.

- Duhet të paraqiten në mënyrë analitike, të grupuara, llogaritjet e amortizimit për vitin 2017.

- Shoqëria nuk ka propozuar një normë të kthimit mbi kapitalin (WACC), në zbatim të formulës për llogaritëse të nenit 10 të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”, por paraqet një vlerë fikse të këtij elementi të të ardhurave të kërkuara.

- Aplikimi nuk paraqet një vlerësim mbi konkurrueshmërinë e çmimeve të gazit për klientët fundorë.

- Për mungesën e dokumentacionit dhe të dhënave që kanë të bëjnë me parashikimet e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, të bordit të ERE-s, do të njoftohet subjekti që t'i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a., për vitin 2018.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë shoqërinë Albgaz sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

NJOFTIM
Nr. 827, datë 17.1.2018

MBI HYRJEN NË FUQI TË MoU ME
AZERBAJXHANIN

Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit për bashkëpunimin për zhvillimin e Masterplanit të Gazit të Shqipërisë, nënshkruar në Tiranë, më 19.12.2014, hyrë në fuqi më 14.11.2017.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë